

Korrupsioni - pranga Buzos, kryekomunarit të Trebinjës

Gjergji Buzo u vu në pranga pasi i mori para një ish-punonjësi për t'i dhënë paratë e fituara pas pushimit të padrejtë nga puna

Sipas burimeve nga policia, mësohet se shtetasi me inicialet A.I. ishte pushuar nga puna një vit më parë nga kryetari i komunës Trebinjë. Duke e quajtur të padrejtë këtë vendim, ai e ka çuar çështjen në gjyq, ndërkohë që gjykata i

ka dhënë të drejtë.

Si rrjedhojë, në vendimin e togave të zeza, komuna e Trebinjës i detyrohej ish-punonjësit të vet për largimin pa të drejtë nga puna një sasi prej 400 000 lekësh të reja. (faqe 3)

UDHËTIM NË PRIZREN: NË KËRKIM TË VARRIT TË BARDHO LEKËS



Nga Bedri BLOSHMI

Ka kaluar më shumë se një vit, që kur unë iu drejtova Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Bamir Topi. I ndjeri Genc Leka, para se të pushkatohej, më kishte

lënë një amanet. Pse them më kishte lënë? Genc Bardho Leka, duke pritur vdekjen, lidhur këmbë e duar në birucën nr.1 të degës së punëve të brendshme në Librazhd, ia la këtë amanet bashkëpunëtorit (b.p.) (FAQE 7)



INTERVISTË ME Z. PETRIT LEKA, ISH-KRYETARIN E PARË TË PD-SË, DEGA POGRADEC, NË VITET 1991-1992

"Ndjehem mirë kur dëgjoj dhe shikoj përparimet e Mokrës"

Atëherë a mund të rrinte indiferent një intelektual nga Mokra në këto çaste? Kudo që isha, në vizita apo në familje të miqve apo të sëmurë, mundohesha të shpjegoja, me aq sa dija, rëndësinë e ndryshimit paqësor të sistemit.

faqe 2-3



Rikthimi i Kutelit në vendlindje

Pogradeci festoi ditën e përrurimit të përmendores së Dhimitër Paskos - Kutelit

Nga Koço PIHONI

faqe 5

"ËNDËRRAT KRYQËZOJNË KOHËN"

Libri më i ri i Istref Haxhillarit

AGAVA -

Vajza e Kadmit
 (Tregim sipas rrëfimeve mitike)

Nga Haki BALLIU

INTERVISTË ME Z. PETRIT LEKA, ISH-KRYETARIN E PARË TË PD-SË, DEGA POGRADEC, NË VITET 1991-1992

“Ndjehem mirë kur dëgjoj dhe shikoj përparimet e Mokrës”

Nga Pëllub ZADE

Intelektuali nga Mokra, Dr. Petrit Leka, është një nga ata njerëz që kur e lyp nevoja dhe interesi i përgjithshëm, la punën e qetë e të nderuar të doktorit ushtarak, për t'u angazhuar realisht në ndërrimin e një sistemi diktatorial, që i solli popullit shqiptar në përgjithësi e atij të Mokrës në veçanti, një jetë të vështirë e të përballeshme ekonomike, me shumë probleme e halle. Kanë kaluar shumë vite që atëherë dhe sot doktori ushtron përsëri profesionin e tij të nderuar e human, në shërbim të njerëzve që kanë nevojë. Intervista e mëposhtme është një kujtesë për ato vite të stuhishme, vite që sollën lirinë e demokracinë në këtë vend, që aspiron dhe së shpejti do të jetë pjesë e Evropës së ëndërruar prej shekujsh.

- Z.Petrit, ju kishit një profesion të admirueshëm, mjek me një jetë komode në krahasim me të tjerët. Cilat ishin motivet që ju shtynë të linit këtë profesion dhe të futeshit në politikë, duke u zgjedhur kryetar i Partisë Demokratike në rrethin e Pogradecit, në ato vite të vështira të fillimit të pluralizmit në Shqipëri?

- Dr. Petrit Leka: - Në radhë të pare dua t'ju falënderoj ju dhe stafin e gazetës “Mokra” për nderin që më bëni, duke me ftuar të jem pjesë e kësaj interviste. Ju si gazetë keni bere dhe po bëni një pune shume të mire ne evidentimin dhe paraqitjen e vlerave historike, kulturore e shoqërore të zonës sonë, virtytet, cilësitë dhe zakonet e mokrareve të trashëguara deri në ditët tona. Ju keni pasqyruar me saktësi bujarinë, sinqeritetin, dashamirësinë, mikpritjen, trimërinë, atdhedashurinë dhe dëshirën për arsim e dituri, cilësi të vyera këto që karakterizojnë mokrarët dhe që do të shërbejnë si baze e fortë për edukimin e brezave që do të vijnë. Përsa i përket pyetjes, dua të them se angazhimi im në lëvizjen demokratike dhe më pas si drejtues i PD-së në rrethin e Pogradecit, në vitet e vështira të fillimit të pluralizmit politik, ashtu si dhe vetë lëvizja demokratike në Shqipëri, qenë rezultat i një zhvillimi gradual i bindjeve dhe koncepteve të mia në vite, i shpirtit demokrat dhe i atyre cilësive për të cilat fola më lart. Për shumë njerëz qe me njihnin nga afër dhe qe e dëshironin ndryshimin, veprimi im u konsiderua i drejtë, por nga disa te tjerë u konsiderua jo normal, duke i dhënë dhe keqinterpretime që buronin nga bindje te lidhura me diferencimin klasor, indoktrinimin



1991: Petrit Leka, Arben Imami, Pëllumb Zade

komunist, si dhe disa të tjerë të nisur nga cektësia shpirtërore e kulturore shkuan edhe me larg. Duke ju falënderuar edhe një herë për mundësinë që më jepni nëpërmjet kësaj pyetjeje, me lejoni të jap disa shpjegime të cilat mendoj se vlejné edhe sot pasi ka akoma disa njerëz të cilët megjithëse i shijojnë frytet e demokracisë, nisur nga disa vështirësi te tranzicionit, nga gabime nga mungesa e përvojës, si dhe vakumit ligjor, nga tendenca që burojnë nga natyra njerëzore, nga mosfunksionimi i mirë i pushteteve, nga paaftësia apo korrupsioni etj, ne vend që të futen në mënyrë normale në garën e demokracisë në mënyrë te pandërgjegjshme apo të ndërgjegjshme bëhen pengesë ashtu si në fillim. Është e vërtetë qe brezi ynë lindi ne vitet e socializmit dhe u rrit bashke me të. Ne këto vite pati transformime rrënjësore ne te gjitha fushat ekonomike, politike, sociale e kulturore të vendit tonë. Ne

vetë u edukuam me ndjenjën e dashurisë për atdheun e për Partinë “që ishte ideatorja dhe udhëheqësja e këtyre transformimeve”, por ky sistem me ekonominë e centralizuar, ideologjinë sunduese m-I, luftën e klasave që zhvillonte pas një periudhe disa vjeçare zhvillimi, në kushtet e izolimit të plotë nga bota demokratike, ndalimin e fesë e besimit te ZOTI, çoi në një varfërim të thellë ekonomik, depolarizim të theksuar klasor të shoqërisë, duke krijuar një klasë burokratike parazite që, duke synuar të ruante privilegjet e tyre, vonuan hapjen e vendit, gjë që çoi në rritje të pakënaqësisë totale të shoqërisë.

Nga ana tjetër Luftës së Ftohte po i vinte fundi. Rrëzimi i Murit të Berlinit, ngjarjet e Rumanisë, hapja e ambasadave, e shume ngjarje të tjera, si papunësia mbi 80%, zbrazja e tregut, radha për ushqime, mungesa e dritave (mjafton të kujtoj kur ktheheshim me trenin e dytë

me xhama të thyera, në mesin e dimrit, gjate kohës që isha në specializim, sapo kalonim tunelin para nesh dilnin dy pamje: bregu ynë i zhytur në errësirë, ndërsa përballë llamburiste vendi me drita, dhe kur pyesnim pse kjo gjendje thuhet për arsye propagande. Këto dhe shume të tjera nxorën ne shesh demagogjinë dhe dështimin e regjimit dhe bashkë me të dështimin e “lumturisë” socialiste. Atëherë, si mund të durohej kjo gjendje nga brezi i ri dhe nga intelektualët përparimtarë?! Pakënaqësia erdhi në rritje derisa studentët, të rinjtë intelektualë, minatorët, të përndjekur nga sistemi dolën në shesh dhe duke kërkuar ndryshim bënë të mundur krijimin e PD-së, e cila lindi si një domosdoshmëri historike, qe me një front të gjerë do të udhëhiqte popullin shqiptar të realizonte ndryshimin paqësor të sistemit të diktaturës në sistemin e lirisë e demokracisë. Në këto kushte unë, megjithëse ushtarak, e përkraha lëvizjen studentore dhe PD-në pa rezerva dhe, aq më tepër, kur në krye të saj u zgjodh prof.dr. Sali Berisha, i cili tek ne ish-studentet dhe kolegët e tij, gëzonte autoritet dhe respekt. Lindi shpresa e madhe se Shqipëria do të ndryshonte si gjithë kombet tjera të përparuar të Evropës, e cila u forcua akoma me tej kur në mitingun e madh të Tiranës, Sekretari amerikan i Shtetit, Xhejms Bejker, deklaroi: “Kam ardhur këtu i ftuar nga dr. Berisha t'ju shpreh përkrahjen e SHBA për liri e demokraci”. Po kështu radio “Zëri i Amerikës”, i bënte thirrje popullit shqiptar dhe, sidomos intelektualëve, të realizonin ëndrën shekullore të shqiptarëve për liri e demokraci. Atëherë a mund të rrinte indiferent një intelektual nga Mokra në këto çaste? Kudo që isha, në vizita apo në familje të miqve apo të sëmure, mundohesha të shpjegoja, me aq sa dija, rëndësinë e ndryshimit paqësor të sistemit. Për këtë, me gjithë vëllanë tim morën pjesë takimin themelues të PD-së, i organizuar në pallatin e kulturës së qytetit.

- Karriera juaj në PD dhe puna si kryetar i dha frytet e saj në zgjedhjet parlamentare të 22 marsit 1992, plot 18 vjet më parë. PD si në gjithë Shqipërinë, edhe në Pogradec, korri një sukses të madh, duke fituar dy deputetë. Si e kujtoni ju sot atë kohë dhe cilat ishin vështirësitë që hasët?

- Është një nga periudhat me te rëndësishme te jetës sime, të cilën e kujtoj me krenari sepse mu dha mundësia te kontribuoj në ato momente historike. Vështirësitë ishin të shumta, sidomos për mua pasi unë vija nga një

SHKOLLA E RE NË HUDËNISHT

Pas përfundimit të projektit për rikonstruktimin e godinës, më 9 maj 2010 mbi 600 nxënës të Hudënishtit në Pogradec tani do të jenë në mjedisë me komode për zhvillimin e procesit mësimor. Për rikonstruktimin e plotë të godinës dy katëshe të saj u përdorën 25

milon lekë. Shkolla ka kabinet informitike, laborator fizike, kimie dhe biologjie, me të gjitha mjetet e domosdoshme si dhe mjediset e tjera funksionale. Brenda muajt maj 2010 do të përfundojë dhe palestra, rrethimi i shkollës dhe fusha e minifutbollit.

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës “Pelioni”

Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës

Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta “Mokra” ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.poradeci.com/mokra

Pranga për korrupsion kryetarit të komunës së Trebinjës, Buzo

Gjergji Buzo u vu në pranga pasi i mori para një ish-punonjësi për t'i dhënë paratë e fituara pas pushimit të padrejtë nga puna

Ka përfunduar në pranga kryetari i komunës së Trebinjës, Gjergji Buzo, ndërsa ndaj tij është ngritur akuza e "korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendorë". Arrestimi i 42-vjeçarit është bërë nga agentët e policisë pikërisht në kohën që ai po i merrte një sasi parash një ish-punonjësi të komunës, i cili kishte fituar gjyqin me komunën pas pushimit të padrejtë nga puna.

Sipas burimeve nga policia, mësohet se shtetasi me inicialet A.I. ishte pushuar nga puna një vit më parë nga kryetari i komunës Trebinjë. Duke e quajtur të padrejtë këtë vendim, ai e ka çuar çështjen në gjyq, ndërkohë që gjykata i ka dhënë të drejtë.

Si rrjedhojë, në vendimin e togave të zeza, komuna e Trebinjës i detyrohej ish-punonjësit të vet për largimin pa të drejtë nga puna një sasi prej 400 000 lekësh të reja.

Por, pas dhënies së vendimit të gjykatës, kreu i komunës Gjergji Buzo, e kishte zvarritur dhënien e shumës së parave. Më në fund, pak kohë më parë, ai ka folur me ish-punonjësin e vet dhe i ka thënë se do t'ia jepte paratë e vendosura nga gjykata, me kusht që t'i ndanin përgjysmë. Një gjë e tillë është pranuar nga shtetasi A.I., i cili ndërkohë ka njoftuar edhe agjentët e policisë.

Si rrjedhojë, duke qenë se ai duhet t'i jepte një sasi paradhënie kryetarit, nga policia ish-punonjësit i janë siguruar përveç parave, numrat e serisë së të cilëve ishin të regjistruar, edhe një aparat

regjistrimi për bisedën që ata do të zhvillonin në një lokal në qytetin e Pogradecit.

Kështu, gjatë kësaj kohe, në momentin që ish-punonjësi i ka ofruar kryekomunarin paratë e pasi ato janë marrë prej tij, policia ka ndërhyrë duke vënë në pranga 42-vjeçarin Gjergji Buzo.

Në komunikatën zyrtare për shtyp, policia bën të ditur se të dielën u finalizua me sukses operacioni "Ryshfeti" në përfundim të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Gjergji Buzo, 42 vjeç, banor i lagjes nr.2 Pogradec, me detyrë kryetar i komunës Trebinjë.

Sipas policisë, arrestimi i tij u bë pasi ai u kap në flagrancë me një sasi parash, të cilat i kishte marrë në shkëmbim të një favoriti. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një telefon celular, një sasi parash me prerje 13x5000, 5x1000, 1x500 dhe 2x200 lekë të reja.

Gjatë kontrollit në banesë u sekuestrua edhe arma pistoletë tip TT, të cilën ai e mbante me leje. Akuza e ngritur ndaj 42-vjeçarit është "korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendorë". Materialet proceduriale i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec për hetime të mëtejshme.

V.O: Gjergji Buzo e fitoi mandatin e kryetarit me një diferencë shumë të vogël, në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007, i kandiduar nga PSD, perballe kandidatit të -PD-SE. Në Pogradec është rasti i dytë i arrestimit të një kryekomunari për korrupsion.



Sipas policisë, arrestimi i Gjergji Buzos u bë pasi ai u kap në flagrancë me një sasi parash, të cilat i kishte marrë në shkëmbim të një favoriti. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një telefon celular, një sasi parash me prerje 13 x 5000, 5 x 1000, 1 x 500 dhe 2 x 200 lekë të reja

familje e lidhur me Partinë e pushtetit popullor, siç thuhej në atë kohë. Babai im, Mersin Leka, dhe xhaxhai, Qemali, kishin qenë të dy ushtarakë. Xhaxhai tjetër, Hashim Leka, kryetar i këshillit popullor, tjetri, Isa Leka, ekonomist, të cilët gjej rastin sot t'i falënderoj për mbështetjen që më dhanë mua në aktivitetin tim. Në atë kohë kisha dhe gjyshen gjallë, e cila, me merak të madh, siç e kanë gjyshet tona të dashura, më tha: "Mire e ke, po shumë mundim i shkaktove vetes" dhe me uroi "Zoti të ndihmoftë!" Gjyshi dhe gjyshja ime ishin të dy besimtarë të sinqertë, shumë punëtorë dhe shumë mikpritës. I theksova këto se pati shumë njerëz që e keqinterpretuan zgjedhjen time si kryetar i PD-së, nisur nga prejardhja ime, duke me krijuar edhe vështirësi të mëdha në punën time, sidomos pas zgjedhjeve. Duke i mirëkuptuar, si rrjedhim i diferencimit klasor nga vinim, pranova të kandidoj dhe në konferencën e parë të rrethit, unë u zgjodha kryetar dhe z. Jemin Gjana sekretar i PD-së. Menjëherë mblodhëm kryesinë e re për të organizuar punën që të mbanim premtimin e dhënë se do të arrinim fitoren. Aty e pashe me mire se ishte një barre e rëndë, por pa e shkëputur aktivitetin si mjek pasi kjo me krijonte me lehte komunikimin me njerëzit dhe krijonte mundësinë e sqarimit të veprimtimit tim dhe të proceseve demokratike që po zhvilloheshin. Filluam me organizimin e degës së PD në rreth. Duhej të shtrihej

puna organizative, që nënkuptonte krijimin e grupseksioneve dhe seksioneve, pra duhej forcuar puna e aktivitetit që si parti elektorale të bënte të qarte programin, të fitonte dhe të realizonte reformat e sistemit demokratik. Nga ana tjetër duhej që të jepnim kontributin tonë si në drejtim të ruajtjes së paqes sociale dhe shërbimit ndaj popullit. Sigurisht, tani duket si një diçka e kaluar dhe e lehtë po për ne që morëm pjesë aktivisht në këtë proces, që shumë e vështirë. Si rezultat i kësaj pune të madhe ne arritëm që të fitojmë dy deputetë z Jemin Gjana dhe z Arben Meçe si dhe këshillin e rrethit, ne krye të të cilit aktivi i degës zgjedhjeve inxhinierin e palodhur, z. Genc Jorgoni. Të gjithë, pa përjashtim, në këtë fitore kanë meritën e tyre, por unë do të përmendja në mënyrë të veçantë kontributin që dhanë Namik Hysenbegasi, Tomorr Aliçollli, Dr. Misto Marko, Përparim Isufi, Pëllumb Zade, Kudret Leka, pa harruar "Dëshmorin e demokratisë" Shpëtim Elmasllari, i cili e dha jetën e tij të re për një të ardhme dhe do të mbetet burim frymëzimi dhe kujtim i ndritur për të treguar që fitorja u arrit me mundim e sakrificë të mëdha.

- Si dhe sa e njihni zonën e popullit e Mokrës?

- Në fëmijëri, në Mokër kaloja pushimet e verës, pasi im atë ka shërbyer në kufi dhe ne familjarisht jetonim pranë postave kufitare ku ai shërbente. Por mbaj mend që sapo mbaronte viti

shkollor gjyshi vinte na merrte dhe verën e kaloja në Proptisht e Slabinjë, ku kisha gjyshërit dhe në Vërrin e Somotinë ku kisha hallat, kudo dashuri e mikëpritje si nip të parë që më kishin. Njohjen më të plote me Mokrën e kam gjatë kohës kur drejtoja degën e PD-së në Pogradec. Atëherë mu dha mundësia të shkoja në çdo fshat e shtëpia, ku megjithë varfërinë e viteve të fundit të socializmit dhe paqartësinë e duhur partiake, mokratët kudo më pritën me dashamirësi. Po kështu kanë ndikuar më pas edhe shkrimet e mikut tim Haki Balliu dhe shkrimet e tjera të gazetës tuaj, të cilat plotësuan njohuritë e mia për historinë e lavdishme të Mokrës. Ndjehem mirë kur dëgjoj dhe shikoj përparimet e Mokrës dhe jam krenar për vendlindjen e prindërve të mi.

- Ç'mendoni për një perspektivë ekonomike të zonës, pas ndërtimit të mundshëm të autostradës Qukës - Qafë Pllaçë, e projektuar dhe që do të ndërtohet nga qeveria demokratike?

- Rrugët janë arteriet, enët e gjakut të një vendi dhe ndërtimi i kësaj autostrade ka një rëndësi të madhe pasi do të ndihmojë zhvillimin ekonomik, social e kulturor të zonës dhe bashkë me ndërtimin dhe të rrugëve të tjera ndërmjet fshatrave do të përmirësojë edhe cilësinë jetës së njerëzve. Kjo do të beje që mokrari të lidhet më shumë me tokën ku ka lindur dhe do të kontribuojë më shumë për zhvillimin e saj.

Brezi i ri do të rritet më i shëndetshëm, do ta dojë më shumë dhe do të investojë më shumë për të. Jeta bëhet më e lumtur aty ku njerëzit jetojnë dhe punojnë për të.

- Cili është aktiviteti juaj i sotëm?

- Mbas specializimit tim të fundit në onkologji dhe disa vjet pune në Gardën e Republikës jam duke punuar për riorganizimin e shoqatës mjekësore "Avicena" dhe si mjek i kujdesit paliativ që trajton të sëmurët me sëmundje të rënda. Shoqata "Avicena" ka pas një aktivitet të gjerë në rrethin e Pogradecit dhe dua që bashkë me kolegët e mi ta vazhdojmë këtë aktivitet në shërbim të jetës e shëndetit të njerëzve.

- Çfarë do të dëshironit t'ju thoni lexuesve të gazetës "Mokra"?

- Lexuesve të gazetës "Mokra" do t'ju uroja në radhë të parë shëndet, mbarësi dhe lumturi në familjet e tyre dhe i këshilloj, si mjek që jam, të tregojnë kujdes të vazhdueshëm për shëndetin e tyre, sidomos për nënën dhe fëmijën për t'i edukuar ata me dashurinë për Zotin, për atdheun dhe vendlindjen e tyre. Rritja e një brezi të edukuar, të arsimuar e të shëndetshëm, do të jetë baza që do t'i garantojë Mokrës mbarësi e prosperitet në zhvillimin e saj.

- Ju faleminderit, z. Petrit!

- Ju faleminderit juve dhe suksese në misionin tuaj!



Nga Haki BALLIU

AGAVA

Vajza e Kadmit

(Tregim sipas rrëfimeve mitike)

ISHTE EPOKA KUR KOHA HANTE BIJTË E VET

Në ditën e tridhjetë e nëntë të mar-tesës së dytë, kur Llyko ledhatonte lumturisht flokët e Agavës se fituar me pesë dyluftime, në kokën e saj lëvizte krimi ndaj tij. Vendimin pa kthim e kishin marrë dajallarët, qysh në çastin fatal kur ai u grabiti mbesën me prejardhje gjysmë hyjnore. Mbetej të caktohej vendi, forcat dhe momenti. Llyko, përveç se dinak e supertrim, ishte i mësuar me vrasje, i mbuluar me lavdinë e qytetit. Lavdinë e fituar e quante perëndinë e tij mbrojtëse. Për sytë e veteranëve ai rrezatonte rini e liri. Përpara bukurosheve fisnike ndihej disi engjëllor, sepse ishte blatur me admirimin e tyre, kur asnjërin nuk e bëri të vuante. Për nga fuqia triumfonte edhe mbi ata që e quanin veten përfaqësues të Zotit. Për këto arsye po përgatitej me kujdes arma vrasare: një gjarpër që mblidhte helmin mbyllur në qyp, si dhe shpirti i Agavës urrejtjen.

Agava robinjë

Fillesa që do të thërriste ngjarjet tragjike u bë ndodhia e tridhjetë e nëntë ditëve të shkuara. Aty ku gurat burojnë të pastra nga shkëmbinjtë për t'i dhënë jetë liqenit, ishte shfaqur një femër e paparë kurrë më parë. Me lëvizjen e kokës kishte bërë një tog përshëndetjesh dhe ishte larguar malit përpjetë, nën shoqërimin e pesë ushtarëve. Këta, me pamjen e luftëtarit tartar, përlunin armët në nderim të saj, njësoj si të përleshin në adhurim të një perëndeshe.

Ndër vendasit që u ndodhën atë çast ishte dhe motra e Llykos, baresha Rea. Në sytë e kësaj e panjohura u fanit si një engjëll rebel, apo si femër me epshe hyjnore. Që ajo mos bënte hije mbi tokën e Enkelejve duhej dëbuar, në mos vrrarë. Sapo i dha lajmin vëllai, ky u nis furtunë me dhjetë djem trima. Nuk e pati vështirë t'i arrinte e t'i fuste në kurth. E vështirë ishte të kapte gjallë ushtarët e huaj, të cilët u dukën si spartanë të tmerrshëm të lindur nga dhëmbët e gjarpërit. Ata dhanë shenjë se vasha gjysmëzhveshur në sy të diellit ishte e paprekshme. Llyka, i frymëzuar nga bukuria e saj, e futi veten në dyluftim mizor. Triumfoi kur vrau të pestin. Atëherë pa se vasha mblodhi buzët gonxhe si të donte ta puthte. Sytë e saj ruanin ngjyrën e qiellit, balli rrezatimin e diellit, mjekra formën e vezës. Nëse Llyka do ta porosiste të perëndesha Afërdita e lindur nga shkuma e detit, më e bukur s'mund të krijohet. Ajo nxitoi t'i thotë emrin: *Agava*. Mbase deshi t'i bënte me dije se ishte bijë hyjneshe, por Llyko as e dëgjoi dhe as e mëshiroi. Si në sjelljet e prijësve pellazgë me femrat greke në Olimp, kështu dhe ai plaçkën e luftës nuk e ndau me të tjerët. E shpuri në shtëpi, duke harruar se shtratin duhej t'ia lironte e shoqja në të lindur, Tadea.

Qerria e së keqes

Gjithë natën hëna hënëronte në sytë e pafjetur të kunatave. Tadea u kullua së qari. Rea nuk përmbante dot inatin. "Do ta vras shtrigën", - tha. "Jo, jo. Më mirë t'i lutemi Llykos", - mendonte Tadea. Pritën sa rrotulla vigane e diellit u ngrit mbi malin e vet. Agava, me siguri, bënte gjumin e parë. Llyko doli të ulej në holl. Rea iu përgjësua:

-Vëllai im, i miri i botës! Nxire nga shpirti xhindin e ardhur s'dihet prej ku e s'dihet përse.

Tadea, me gishtin mbi barkun e fryrë, vetëm e pyeti:

-Zot, a do ta durojë robinja jote të qarët e foshnjës që ti ke mbjellë te unë?

Në vend të përgjigjes ai u dha urdhër:

-Ti, motër mendjelehtë, shko merr këshilla te orakulli Thation. Ti, Tadea, grua e rëndë, nisu të lindësh në malin e Diellit!

Sjellja fodulle e tij ngjalli zemërimin e kunatave për ikje të menjëhershme. U nisën mbi të njëjtin kalë, në të njëjtin drejtim. Kur arritën në tempullin e gurtë, Thationin e gjetën rrethuar nga nëntë fatrrëfytes. Këta të ndarë në tre e tre, çonin pyetje dhe merrnin përgjigje në tre tempujt apo orakujt e Apolonit: Në Delf, Klara dhe Didima. Rea u foli me një dëlirësi hyjnore për "xhindin" që kishte hyrë në shpirtin e të vëllait. Pastaj radhën e mori Tadea:

-O Profet i urtë, këshillues i Enkelejve dhe Eordejve! Zëri yt është vraga nga duhet të kalojë im shoq për të shpëtuar...

Orakulli Thation sikur ra në një dremitje të rremë. Rrudhat e ballit iu bënë më të plakura, mjekra ca më e bardhë, e varur gjer në gjoks. Kunatave iu duk se ai ra në një lloj rraskapitje, si ta trazonin valët e ndërgjegjes për ç'ka i duhej të këshillonte. Një çast kështu dhe zëri i tij i qetë u ndje nëpër banesë si një psherëtimë e dalë nga shpirti i gurëve. Po më shumë se sa këshilla, ligjëroi:

-Qoftë me ju Zoti ynë i luftës dhe mbrojtësi i shëndetit, Medaur! Ju të dyja jeni të mençura sa nëntë muzat. Ju ndjeni sa dhe unë. Nuk është Llyko, mbreti ynë fatrrëzuar që fitoi Agavën. Është ajo që robëroi shpirtin e tij. Agava ka për nënë hyjneshën Marimona. Qerria e së keqes sollti në anët tona dhe dy vëllezërit e saj me shpirt të ulët tragjik: Tmerrin dhe Panikun. Të tre kanë për atë Aresin, Zotin e Luftës. Ares është bir i kryeperëndisë Zeus. Zeusi ngadhënjëu kur mundi atin e tij, Kronosin që gëlltiste fëmijët e vet të porsalindur. Prej atëherë Zeusi u bë zot i Botës. Po një herë u shndërrua në dem i bardhë dhe rrëmbeu Europën, motrën e Kadmosit. Kadmi, si i flasin në Tebë, është babai i Agavës. Po ndryshe nga dajat e saj, dua të besoj se Kadmi e sollti në anët tona rruga në kërkim të Europës...

Zjarri i fjalëve në buzët e profetit u shua. Tadea shumë gjëra nuk i kuptoi e as i duheshin. Ndërsa Rea, nga gjithësa dëgjoi, kapi vetëm domethënien e fundit, se ai, Kadmi që kishte bërë disa vite udhëtim në kërkim të së motrës, duhej të ishte burrë shpirt-dhembshur. Iu lut Thationit të dinte diçka më shumë. Po nga goja e tij doli vetëm një fjalë:

-Për Kadmosin, mësuesin e njerëzimit, legjendës i duhen 13 breza që të thuret.

Reas iu bë se engjëlli lajmëtar i fryri në vesh: "Shko te ai". Mbase doli nga tempulli i gurtë, la Tadenë te plaka e Eordejt dhe mori rrugën që e çonte andej ku lumi Ohdrin buronte prej mitrës së liqenit Lihnidë. Asaj ane thuhej se fushonte Ai, mësues i shkrimit, me dorën e miqësisë shtrirë Enkelejve.

Krahët e shpirtit

Në ditën e dyzetë të martesës Llyko me Agavën u panë të shëtisnin me pajton. Kurioziteti i banorëve tanimë mezi mbahej gjallë. Në ato dyzet ditë qyteti i merakosur priste se ç'ndryshime vallë mund të sillte vjeshta. Vjeshta erdhi me diell të lodhur nga vapa e verës dhe admirimi i banorëve për mbretin e tyre ishte zbehur. I gërryente thashethemi se Agava si dhe e motra Semela kishin nga një histori çmendurie, se nga ana e nënës vinin nga një racë e stërvitur me të keqen, se dhe vetë Kadmi ishte i dëbuar dhe i mallkuari i Tebës. E çuditërisht mbreti i Enkelejve kishte futur mallkimin në shtrat, kur ushtria kishte humbur rregullin, qyteti qetësinë; kur murgj të panjohur me ecje të ngathët barisnin nëpër qytet kokëvarur si të shko-

nin përpara litarit. Nëse këta lypnin mëshirën e qytetarëve, në periferi shfaqeshin burra të armatosur mbuluar me leshra që trembnin bagëtitë dhe fëmijët.

Veteranët e luftës parandienin se dreqësitë e botës kurdisnin fshehur të zezën e Enkelisë mbujtur me djersën, lotët e gjakun e vet. Më i moshuari, Bima, i preu rrugën mbretit. Për herën e parë i foli në emër:

-Dëgjomë, o Llyko. Me këto prapësi që po na sjell, krenarisë sonë i shkule krahët e shpirtit, vetes fisnikërinë.

Pajtoni i tij uli pak shpejtësinë, por nuk ndali. Pas pak kuajt shfrynë lodhjen në peizazhin e virgjër poshtë malit të Diellit. Agava pyeti:

-Pse kaq i thatë Kryemali juaj? A ka lindur pa gëzofin e gjelbër, apo e kanë zhuritur rrufetë e Zeusit?

-Ka lindur fort i bukur, por bukuria e tij ka zbritur këtu poshtë, buzëqeshi ai duke treguar me gisht peizazhin nën këmbët e malit.

Aty pranë gurrave që buronin si një shpirt i gjallë, në mes të asaj qetësie dhe gjelbërimi të virgjër, ku toka buzëqeshte dhe bari dukej i vesuar me lot; aty ku qielli e liqeni ishin një, ku flladi i ditës e përkëdhelte si fryma e muzave, Agavën e kapi iluzioni se mos vallë aty kishte lindur shpirti i perëndeshës Gea, apo ishte vendi Nimfave që rritën Zeusin bebe. Mbase ra në gjuhë e mrekulluar, mendja i fiksoj vendimin: "Ja parajsa ku duhet të mbretërojë im atë". Mendja dhe epshet e saj shpërthenin çast pas çasti, si zjarrmthi. Llyko shtriu dorën ta ngrinte, po ajo e tërhoqi mbi vete. Ushtarët u sprapsën me shpinën kthyer skenës së dashurisë, të cilën mbreti i tyre për herë të parë e kryente në natyrë.

Nën ndijimet e kënaqësisë, kur gjuhët përziejshin nëpër gojë e njëri tjetrit, mendja e Agavës u çlirua një çast prej hijes së kimit "Dua një fëmijë nga ty" i tha Llykos. Dhe e dëshironte vërtet. Ajo besonte se mbreti enkeleas rridhte nga raca e ciklopëve, bijë të Geas. Njëherësh shpresonte se pjella e tyre do të rritej gjigand. Sigurisht Llikon do ta vriste sapo të ndjente lidhjen e foshnjës në bark.

Mbas të nginjurit me dashuri Llykos i shkrepri të mbante një fjalim prej ushtaraku: "Unë e di, o Agavë. E di se sot apo mot do të ndeshem me shkelës që kanë mes vetes prijës përbindësh të lindur nga martesat e grave vdekatare me demonë. Që të triumfoj mbi ata, o lumturia ime, dua të të kem në vithet e kalit. Frymë-marrja jote është flladi i perëndisë sime".

Dinakëria e Agavës, si dhe e kobrës mbyllur në qyp, e pëlqeu dëshirën e tij si mundësinë më të lehtë për ta vrrarë me thikë pas shpine. Vdekja do të besohej pastër vrasje në luftë sepse banorët e atij vendi që quhej Enkel, përveçse atdhetarë të flaktë, seç kishin një shpirt të patrazuar me djallëzitë. Për Llykon kujtesa do të ruante heroikën, për Agavën lavdinë. Morti i të parit do të kremtohej me nderime të mëdha, ngadhënjimi i Agavës mundësonte thirrjen e të atit në fronin mbretëror. Ky pra do të ishte i dëbuar i Tebës, për të cilin veteranët e Bimas i brente dyshimi: nëse Kadmi u sillte lirinë Enkelejve apo vinte të plagoste gëzimin e lirisë së tyre?

Intermexo

Kujtojmë se ishte epoka kur koha hante bijtë e vetë: Shekujt, muajt, javët, ditët si Kronosi gëlltiste papërtypur fëmijët e tij të sapolindur. Nga Kadmi fenikas i viteve 1600 deri te stërnipi i tij, që thirri Herkulin pellazg të shpëtonte Dyrahun enkeleas, koha hëngri gati katër shekuj. Vërtetohet kështu profecia e Orakullit Thation: që të thurej legjenda e Kadmit u deshën trembëdhjetë breza. Po legjendën e plotë do ta shkruajmë më vonë...

(vijon në numrin tjetër)

Rikthimi i Kutelit në vendlindje

Pogradeci festoi ditën e përrurimit të përmendores së Dhimitër Paskos - Kutelit

Nga Koço PIHONI

Sot si rrallë herë qytetarët e këtij qyteti janë mbledhur në sheshin para bulevardit kryesor në qendër të qytetit, para pallatit të kulturës "Lasgush Poradeci" e bibliotekës në anën tjetër që mban emrin "Mitrush Kuteli", për të marrë pjesë në përrurimin, inaugurimin e përmendores madhështore, të punuar me aq mjeshtëri e dashuri nga "Skulptori i Popullit" Muntaz Dhrami. E vendosur në sheshin e gjelbëruar buzë liqenit, përballë përmendores së Lasgushit, të vendosur aty mëse një vit më parë, duke sikur Lasgushi atë po priste, sipas "fjalës" së dhënë një vit më parë se në atë shesh nga vetë kryetari i bashkisë, z. Shkëmbi. Ndaj Lasgushi priste t'i vinte Mitrushi, t'i urontë atij mirëseardhjen! Tashmë e tutje ata kanë për të qëndruar bashkë e për të mos u ndarë më kurrë për jetë të jetëve! Këta dy shokë, miq e korifej të fjalës e letrave shqipe, në atë vend që i lindi, i rriti i deshi dhe e deshin, ndaj sot ky popull po i nderon si u ka hije, si rrallë kush bijtë e tij, se janë bijtë e gjithë Shqipërisë e kombit mbarë.

Në 27 prill 2010 qyteti i Pogradecit e pogradecarët u nderuan me ardhjen e shumë miqve e të shumë të ftuarve nga qytete e vise të Shqipërisë, si Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Elbasani, Korça etj, apo edhe nga qyteti i Strugës e Ohrit. I pranishëm vetë kryetari i bashkisë, z. Ramiz Merko e mysafirë të tjerë të nderuar që krijuan një atmosferë shumë festive e miqësore për të gjithë. Kjo ditë, me rastin e 103- vjetorin të lindjes së shkrimtarit, poetit, Kutelit të madh, na solli një dhuratë shumë të çmuar. Në këtë festim të këtij përrurimi, i përgatitur me shumë seriozitet e madhështi nga pushtetit vendor ishte një ngjarje e madhe, e paharueshme.

Për fat të keq ra në sy mungesa e shetit, por kjo nuk e prishi aspak festën!

Në vitin 1997 një nga miqtë e Kutelit, z. Petraq Kolevica, shkroi një libër të titulluar "Me Mitrushin", me rastin e 30 vjetorit të ndarjes së tij nga jeta. Z. Kolevica e bren meraku për fatin e vlerësimit të këtij personaliteti të letrave, prandaj dhe ai atëhere shkruante: "Dikur kam shkruar se Pogradeci që ka bij të vetët të mëdhenjtë Lasgush e Mitrush, mund të quhej Weimari Shqiptar, Mirëpo Weimari e ka ngritur prej kohësh monumentin e Gëtes e të Shilerit! Pogradeci, kur do ta ngrrej monumentin e bijve të tij ta mëdhenj?" Dhe më poshtë pyet e thotë: "Më thoni, cila shkollë mban emrin e Mitrushit, cila shtëpi botuese, cila rrugë, cili shesh mban emrin e tij? Cili skulptor i ka bërë ndonjë bust? Cili piktor i ka bërë portretin? . . . A ju dha ndonjë titull, urdhër, apo dekoratë? ", dhe vetëpërgjigjet: "Ishin mbaruar?"

Por sot, unë si qytetar pogradecar, me lehtësi e krenari, mundet t'i përgjigjem dilemave të dikurshme të Kolevicës:

"Falë seriozitetit e vlerësimit nga pushteti vendor dhe qytetarisë e shoqërisë civile, sot janë të bëra realitet monumentet madhështorë të Lasgushit e Kutelit, përjetësimi i emrit të tij, biblioteka e qytetit mban emrin "Mitrushi Kuteli", Këshilli Bashkiak e ka nderuar me titullin e lartë "Qytetar Nderi". Por-



tretin e tij e shikon në shumë kënde të shkollave të mesme të qytetit e gjetiu e se së shpejti një shkollë e mesme e përgjithshme, në pronësi të zotit Niko Krëstes, atje pranë "Lumit të Madh" për të cilin ka shkruar i madh Kuteli, do mbajë emrin e tij.

Përrurimi i kësaj përmendore bëhej krahas shumë investimeve në infrastrukturën rrugore, shesheve, parqeve, mbjelljeve të mijëra pemëve dekorative, ambienteve çlodhëse e kënde lojërash e kënde për të moshuar, krahas pastrimit të bregut të zonës së plazhit. Të gjitha këto e kanë hijeshuar qytetin dhe e kanë bërë më shumë të vizituar nga pushuesit e vendit e ata të huajt. Të gjitha këto falë punës së ndershme e me përkushtim të kolektivit punonjës të kësaj bashkie, në saj të një administrimi të kujdesshëm të taksave të qytetarëve apo donacioneve të ndryshme të përdorura me ndershmëri dhe në drejtimin e duhur.

Fjalën përshëndetëse e mbajti kryetari i Bashkisë z. Artan Shkëmbi, i cili falënderoi së pari të gjithë të pranishmit, veçmas miqtë e të ardhurit e shumë nga i gjithë vendi. "Përrurimi i kësaj veprë është fjalë e dhënë para qytetarëve një vit më parë në përrurimin e përmendores së poetit tonë të madh Lasgush Poradeci. Një popull që nuk nderon lavdinë e të shkuarën e tij dhe që nuk përulet me respekt e nderim përpara bijve të tij, që kanë bërë epokë e kanë hyrë në histori, nuk meriton një të ardhme më të mirë", - tha veç të tjerash në fjalën e tij z. Shkëmbi.

Në fjalën e tija kryetari foli edhe për përrurime të mëtejshme, të menduara nga Bashkia edhe gjate viteve të mandatit të ardhshëm, në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së qytetit dhe përrurime të tjera për personalitete të shquara të qytetit, gjatë viteve në vazhdim. Veçanërisht z. Shkëmbi falënderoi për përkushtimin e punën e madhe, monumentale "Skulptorin e Popullit" zotit Muntaz Dhrami, të cilin e



konsideroi si një mik të madh të qytetit tonë e gjithë pogradecarëve.

Më këtë përrurim z. Shkëmbi bindi çdo skeptik dhe mori mirënjohjen e të gjithë qytetarëve pa dallim, besimi e bindje politike, të majtë e të djathtë. Pogradecarët treguan kulturë, qytetërim. Kryetari i bashkisë i ngjante atij "Kostandinit" legjendar që mbajti "besën e dhënë", që e bëri realitet premtimin e tij.

Përshëndeti pjesëmarrësit në këtë përrurim edhe i biri i Kutelit, z. Pandeli Pasko. Në fjalën e tij, veç të tjerash, ai tha: "Pogradecarët e treguan veten shumë të afërt me atë traditë që na ka ushqyer në vite, me dashurinë e respektin për njëri-tjetrin. Kjo gjë na bashkoi sot të gjithë pranë monumentit të Kutelit dhe një meritë e veçantë i takon bashkisë që ka ditur të lexojë ndjenjat e qytetarëve të saj për Kutelin. Unë sot kam përjetuar emocione të mëdha. Nderimi që i bëhet sot babait, jam i sigurt se edhe ai vetë, e ka "ndjerë" atje ku ai prehet. Pogradeci tashti do jetë për atë si nderim i gjithë Shqipërisë. Ju Faleminderit!"

Përshëndeti edhe skulptori Muntaz Dhrami. Në fjalën e tij, ai u shpreh se ndjehej i emocionuar e shumë i nderuar për vlerësimin, punë e veprën e Kutelit. "Është nder e fatmirësi për mua, të jem autori i përmendoreve të këtyre të dy ko-

rifenjve të letrave shqipe, mbase jeni ju qytetarë të nderuar, që më inkurajuat e sugjeruat mendimet tuaja që dhe unë t'i përkushtohesha realizimit të përjetësimin të dy korifenjve të mëdhenj, Lasgushin e Mitrushin. Tashmë ata do të jenë këtu, mbi tokën e vendlindjes e të flasin, të "ççurisin", ashtu si dinin ata të kuendonin e t'i këndonin punëve e dashurisë. Më duhet të kujtoj disa fjalë të thëna nga Lasgushi për mikun e tij: "Si ka shkruar Mitrushi, nuk ka shkruar Askushi! Më lejoni që dhe unë të falënderoj bashkinë për mbështetjen e përkrahjen që më ka dhënë dhe ta siguroj z. Shkëmbi se do jem i pakursyer për të bashkëpunuar edhe më pas me ju dhe qytetarët e këtij qyteti të mrekullueshëm për vepra të tjera!" Më pas, në mes të shumë duartrokitjeve, u bë zbulimi i përmendores së Dhimitër Paskos, Kutelit, nga z. Artan Shkëmbi, z. Pandeli Pasko e z. Muntaz Dhrami, si dhe pjesëtarë të tjerë të familjes e të ftuar të tjerë.

Njëra nga tre vajzat e Mitrushit, znj. Atalanta Pasko interpretoi vargje nga poezi të pabotuara ende të babait të saj. Qytetarët bënë foto të shumta, duke e përjetësuar e çuar në çdo familje këtë përrurim, kujtim nga kjo ditë e veçantë dhe e pa harruar nga të gjithë.

Aktivitetet vazhduan sipas programit të hartuar nga bashkia.

DRAMA E FAMILJES TË ALUSH ÇELËS, NË VELÇAN

Nga Halit ÇELA

Pas Kongresit të Përmetit më 24 maj 1944, pushtuesit gjermanë organizuan mësymjen e qershorit. Në Mokër, Këshilli Krahinor dhe forcat territoriale të krahinës, u vunë në gatishmëri për të mbajtur nën kontroll çdo lëvizje të armikut. Fillimet e operacionit të armikut në qershor 1944, një pjesë e brigadës së IV-S ishte në rajonin e Mokrës dhe të Gorës Lindore, në përbërje të saj të luftimit, ishin edhe batalionet territoriale, batalioni "Reshit Çollaku,, e batalioni "Bërzeshta,,

Komanda e korparmatës XXI, në urdhrin e saj nr. 1 të operacionit të koduar "EINHORN,, më 26 maj 1944 urdhëronte: të pushkatohe në vend, gjithë partizanët dhe partizanet që mund të kapeshin, të arrestohen dhe grumbullohen në vende të caktuara, moshat 16 - 60 vjeç, të digjen, shkatërrohen shtëpitë e fshatarëve, Brenda zonës së mësymjes dhe të merren bagëtitë e tyre, për furnizimin e ushtrisë. (AQP, Dosja e korporates XXII, 1a, br, bat, nr. 1240/44).

Për këtë, brigadës IV-S, vuri detyra në datën 1-3 qershor 1944 për secilën batalion, batalioni "Reshit Çollaku,, në Zhgllap të Katjelit, ura e Manastirecit, lumi Shkumbin në thellësi të Propishtit, batalioni "Bërzeshta,, Manastirec, Qukës-Skëndërbej, në thellësi të Stravajit e tjerë. Nga drejtimi Përrenjas Stravaj, më 3 qershor 1944 filloi mësymjen një grup luftimi gjermano-ballist, por nga qëndrimi luftarak i batalionit të tretë të brigadës IV-S, i batalionit "Reshit Çollaku,, dhe



Alush Çela

batalioni "Bërzeshta,, i thyen dhe i shpartalluan këto forca, dhe bënë të dështojë ky operacion i armikut në këtë rajon, që pati pasojat të favorshme për forcat mbrojtëse të brigadës IV-S. Sami Vinçani, Albert Kotini "Vinçanët,, libri i parë, Tiranë 2000, faqe 252)

Luftimet e Brigadës IV-S, në datën 3-4 qershor 1944 i shkaktuan armikut të vrarë e shumë të plagosur, edhe forcat partizane patën 5 të vrarë, 11 të plagosur, u plagos Beqir Sovjani e Fetah Selca, ishin komandantë. Më datën 3 qershor, komanda gjermane hodhi në mësymje edhe tre grupe të tjera luftimi. Batalioni i 3-të të brigadës IV-S, batalionit "Reshit Çollaku,, dhe batalioni "Bërzeshta,, u vendosen për të mos lejuar depërtimin e armikut në drejtimin Qukës-Mokër, në Qafën e Panjës, në ndihmë të batalionit të brigadës IV-S.

Më datën 9 qershor 1944, forcat gjer-

mano balliste erdhën nga Qukësi në drejtim të Velçanit, dhe më 10 qershor arritën në Velçan, në Llëngë. Kudo ndërmoren një operacion ndëshkimor, brenda një dite, zjarr, terror, vrasje, shtëpi të djegur. Në Llëngë u pushkatuan 20 burra. (Gazeta "Mokra,, Nr 10, nëntor 1999)

Forcat gjermane, e balliste nën komandën e Xhevdet Blloshmit, Nezir Muzhaqit, në malin e Gjemthit, vranë tre burra të një shtëpie, Alush Çelën, me dy djemtë, Asllan Çela dhe Karafil Çela.

Vranë Alush Çelën, një burrë patriot, i dëgjuar, që i kishte dhënë Frontit Nacional-Çlirimtar. Ata e dinin forcën patriotike të kësaj familje në Mokër, Vërçë, Pogradec, Përrenjas e më gjerë, prandaj i vranë bashkë me tre burra të Velçanit, vranë vëllanë e Kristaq Ambo nga qyteti i Pogradecit.

Kjo ngjarje u muar vesh në krahinën e Vërçës, dhe menjëherë Tele Masati e Lamçe Masati nga fshati Kukër, dhe shumë banorë nga fshatrat për rreth i përcollën me nderime në banesën e fundit në malin e Gjemthit. Alush Çela në moshën 60-vjeçare, ishte i njohur dhe patriot. Shtëpia e tij kishte qenë qendër patriotike në Mokër, ka pritur të gjithë patriotët.

Në këtë shtëpi u bë mbledhja e Velçanit më 23 mars 1943, e forcave të Frontit dhe Ballit. Ishtë një bazë e Frontit, dhe kjo familje duhet eliminuar. Ai njihet jo si Alush Çela, por Alushi i Velçanit.

Asllan Çela, ishte djali i madh i Alushit, sepse ai kishte 6 djem, ishte një tregëtar në fshat. Ai ndihmonte banorët e Velçanit, i mbrojti nga xhandarët e Zogut. E vranë në moshën 40-vjeçare.

Karafil Çela, ishte modeli i njeriut, ia

mori jetën në moshën 35-vjeçare, dy muaj pas vrasjes i lindi djali, të cilit i vunë emrin Alush, i cili e meritoi këtë emër. Me të tre jam ndarë dy ditë para se të vriteshin nga armiqët.

Unë Alush Çelën e kisha xhaxha, i cili më donte shumë, si vëllanë e tij, se kish-te emrin e vëllait Halit i cili ishte ndarë nga jeta i ri. Ai më mbante afër, më mëson-te si të bëja dollinë e rakisë, si të këndoja, si të shërbeja në shtëpi miqësisë e tjera.

Për ngushëllim në shtëpinë e Alush Çelës erdhi një ekip i kryesuar nga Haxhi Lleshi, Tuk Jakova, Misto Treska, Pilo Peristeri, e tjerë.

Në rrethimin e Alush Çelës, ishte edhe Neki Çela djali, i cili doli nga rrethimi, kjo ishte një fat i madh. Ai erdhi në fshatin Velçan, lajmëruan komandën e Vëndit, e cila mori masa mbrojtëse.

Pas 19 qershorit 1944 u shpartalluan forcat gjermano-balliste nga brigada e IV-S në përbërje të divizionit parë sulmues. Më 25 qershor 1944 brigadës IV-S, i erdhi urdhëri i Komadës Divizionit I-rë, se do të kalonte në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Më 26 qershor 1944 fshati Velçan përcolli partizanët e brigadës IV-S.

Me largimin e forcave partizane në Mokër vijën forcat e Ballit Kombëtar më të egërsuara nga Vërça, dogjën në Velçan rreth 12 shtëpi dhe dogjën rreth 91 për qind e shtëpive në fshatin Losnik, vranë në Slabinjë. Mokra e përballoi operacionin e qershorit 1944 por pati humbje të mëdha në njerëz, shumë të vrarë, të pushkatuar, shtëpi të djegur, bagëti të marra e tjera. Familja e Alush Çelës e pësoi rëndë, tre burra të vrarë, shumë dhe shumë dëme të tjera.

Dy të vërteta që i mbuloi me dhé diktatori në 4 prill 1944



Nga Eqerem KALANXHI

(Vijon nga numri i kaluar)

Në proces-verbalin e pushkatoimit të firmosur nga Mehmet Shehu dhe Tuk Jakova si dhe në raportin e shkruar dhe të firmosur nga Suat Leskoviku dhe Pilo Peristeri janë shkruar gjëra që nuk janë të vërteta, por janë të sajuara. Vetëm njëra qëndron ajo që Tele Baçi ishte i djathtë dhe bashkëpunonte me të djathtën sepse luftonte për një Shqipëri të lirë e demokratike. Do të sqaroh disa gjëra që ata i ngrinin si çështje: p.sh thoshin se Tele Baçi ishte komandant i paemëruar. Siç kam shkruar edhe me lart Telja ka qene në burg se italianet i dogjën shtëpinë por ai theu burgun, formoi çetën, bëri aksionin e pare kundër italianëve. Atë e vuri komandant çete e më pas komandant batalioni, pas vrasjes së Reshit Çollakut, origjina e tij dhe ndjenja patriotike.

Perse italianet kur erdhën në Shqipëri më 7 prill 1939 nuk dogjën shtëpinë e

Pilo Peristerit por dogjën shtëpinë e Tele Baçit? Pasi Piloja nuk kishte prejardhje patriotike, ashtu sikurse nuk kishin as Misto Treska, ndersa Tuk Jakova ishte prift dhe kishte kryer shkollën ne Vatikan dhe ishte mik me italianet.

Italia fashiste ashtu si ne gjithë Shqipërinë vendosi edhe ne Gjirokastrë administratën e saj si edhe forcat ushtarake por shtëpinë e Enver Hoxhes nuk e dogji pasi nuk e njihje si familje, ndërsa Tele Baci e kishte prejardhjen nga një familje patriotike. Sot thuhet se Dushan Mugosha ka qenë zv/komisar i brigadës së parë sulmuese, por për mendimin tim ai nuk ka qene zëvendës komisar por ka qene komandant i brigadës së parë, ai që ka tërhequr për kapistrë Mehmet Shehun me urdhër të Enver Hoxhës dhe është e sigurt që Tele Baçin e paska pushkatuar Dushan Mugosha me dorën e tij, me urdhër të Enver Hoxhës për të marrë hakun e serbeve që kish vrarë Brahim Baçi, xhaxhai i Tele Baçit. Ata arritën deri atje sa te fushin njerëz për te vrare Brahim Baçin por nuk ia arritën dot qëllimit. Siç më ka treguar Shefqet Baçi, Hatja i Homçanit të Mokrës punonte si hoxhë në Strugë dhe e kish thirrur policia serbe ku e kishin pyetur nëse e njihje Brahim Baçin. Ai ishte



Tele Baçi

përgjigjur se e njihje. Atëherë ata i kishin thënë se do ta armatosnin mirë dhe do ta paguanin me flori që të shkonte te vraste Brahim Baçin se ai ka bere lufte te fuqishme kundër tyre. Ndërsa Hatja i Homçanit i kishte thënë se nuk mund

ta bënte një gjë të tillë sepse Baçët janë një fis i gjerë dhe trimash dhe ia bënin edhe atij me pas ashtu. Për shkak të kësaj përgjigjeje, atë e përzunë dhe ai erdhi e shërbeu si hoxhë në Homçan.

Mokra dhe mokraret e dine se kush ka qene Bajram Curri, Shote Galica, Azem Galica, apo Abaz Kupi, Çerçiz Topulli e shume trima të tjerë, që kane punuar e luftuar për Shqipërinë, që kane sakrifikuar gjene me sublime, jetën. Po atëherë pse Brahim dhe Tele Baci nuk u kujtuan ndonjëherë nga diktatura apo Partia e Punës? Ndaj ta dini, të nderuar lexues, se Brahim Baçi e nipi i tij Tele Baçi rresh-tohen ne burrat trima, patriotë e luftëtarë që i përmenda me lart, te cilët janë nderi, lavdia dhe në mesin e figurave më të shquara të kombit tonë që historia duhet t'i kujtojë gjithmonë.

Sipas dokumenteve të nxjerra nga Arkivi i Shtetit, Brahim Baçi jo vetëm që nuk bashkëpunoi me të huaj, se ai nuk ia lejonte vetes tradhtinë ndaj atdheut, por me zgjuarsinë e tij zbuloi dhe shpartalloi ata që ishin agjente te paguar nga Serbia. Këtë e ka dëshmuar me letër dhe Aqif Pasha Elbasani, titullar i qeverise gjate viteve 1918-1925, gjatë kohës së

Udhëtim në Prizren: Në kërkim të varrit të Bardho Lekës

Nga Bedri BLOSHMI

Ka kaluar më shumë se një vit, që kur unë iu drejtova Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z.Bamir Topi. I ndjeri Genc Leka, para se të pushkatohej, më kishte lënë një amanet. Pse them më kishte lënë? Genc Bardho Leka, duke pritur vdekjen, lidhur këmbë e duar në birucën nr.1 të degës së punëve të brendshme në Librazhd, ia la këtë amanet bashkëpunëtorit (b.p.) "Lundronjësi" (Iljaz Balliu - i dënuar ordiner) nga Çermenika: "S'kam se si t'i çoj fjalë Bedriut, që t'i le një amanet. Bedriu është dënuar shumë dhe zor s'e del nga burgu me atë kokë që ka. Megjithatë po doli e di që do ta kryej. Të interesohet të më gjejësh eshtrat e babait, Bardho Lekës e të m'i sjell në Shqipëri."

Në vitin 1951 Bardho Leka, duke parë se po ia mblidhnin lakun në fyt, u arratis për në Jugosllavi. Po ku qëndroi ai deri sa dha shpirt nga dëshpërimi? Bardhoja pasi kaloi telat me gjemba të Shqipërisë burg, u vendos në gjysmën tjetër të Shqipërisë, në Kosovë (më 1913, Fuqitë e Mëdha vendosën të shuajnë grykësinë e Beogradit dhe Athinës, Kosova iu dha Jugosllavisë dhe Çamëria iu fal Greqisë), në qytetin e Prizrenit ku edhe dha frymën e fundit.

Interesimi i z.Bamir Topi bëri që unë të marr një përgjigje nga Ministria e Punëve të Jashtme, se ku ndodhej e kush ishte ai që dinte se ku preheshin eshtrat e Bardho Lekës. Më poshtë po bashkëngjiti një pjesë të njoftimit zyrtar që përmenda pak më sipër.

Jo më larg se data 24.04.2010 mora rrugën për Prizren me dy miqtë e mi. Kërkova dhe gjeta personin e adresuar. Ky i fundit më drejtoi te një shqiptar i arratisur i cili mbante jo më pak se 100 e ca vite mbi supë. Ai na priti në kullën e tij gjithë dashamirësi dhe plot respekt e me lot në sy filloj të tregonte. Njërin



FOTO E BARDHO LEKES NE VITET E FUNDIT, LETRA NGA MINISTRIA E JASHTME DHE ORA E DORES E BARDHO LEKES



vesh e kishte të shurdhër. Këtë "dhu-ratë" e kishte nga torturat e sigurimit të shtetit-bandë komunist. Pasi i dhurova disa fotografi të Bardho dhe Genc Lekës të cilat e bindën për vërtetësinë e thënieve të mia, ai futi dorën në xhepin e brendshëm të xhakës e nxori prej andej një orë "Marvin" të markës zvicerane, me një gjysmë rripi të kalbur, që pas mbante mbishkrimin: "Bardho Leka". "Ja Bedri, - më tha. - Kjo është ora e Bardho Lekës. Ia hoqa nga dora ditën që e gjetëm pa jetë në dhomën e tij. Kish-

te vdekur prej disa ditësh, i vetëm pa njeri pranë. Para se të vdiste ishte shumë i dëshpëruar. E kam varrosur me duart e mia afër familjes sime."

Sa s'më ra të fikët. Ndeza një cigare menjëherë. Të tronditur siç ishim dolëm e morëm rrugën për në varreza. Atje ndodheshin tri varre pa emër e të harruar nga njerëzit e koha. "Unë tani nuk e mbaj mend more bir, kam mbi supë 104 vjet, por njëri nga këta është Bardho Leka", tha burri i moçëm.

Njeriu që na adresoi tek ky shqiptar i moçëm dhe i besës (i adresuari nga Ministria e Punëve të Jashtme) më tha se kishte

pasur edhe një kuti me shkrime të Bardho Lekës, por lufta e Kosovës i kishte vënë zjarrin çdo gjëje. E falënderova dhe u përshëndeta me njeriun që mbante më shumë se një shekull mbi supë të cilit lotët i rridhnin nga faqet mbi mjekrën që i dridhej, jo nga pesha e viteve, por nga malli dhe amaneti i përmbushur.

Nga varrezat morëm rrugën e kthimit për në vendlindje. Mbërrita në shtëpi afër mesit të natës. Ora e Bardho Lekës që vazhdonte të punonte, tik-taket e së cilës të kujtojnë të rrahurat e zemrës, nuk më la të vija gjumë në sy atë natë.




mbretit Zog.


Ndërsa Tele Baçi, nipi i Brahim Baçit, i cili luftoi përkrah xhaxhait te tij kundër serbëve që kur ishte djali i ri, u edukua dhe zhvilloi ndjenjën patriotike ndaj atdheut.

Po pse valle diktatori e pushkatoi dhe i vuri damkën tradhtar, në një kohë që kur ai dha urdhër për pushkatim, i porositi ata që do ta pushkatonin pabesisht dhe të kishin kujdes, se Tele Baçi, komandanti i batalionit të Mokrës kishte influence të madhe në Mokër dhe se shumë mokrarë e donin. Tele Baçi paraqiste një rrezikshmëri për Enverin sepse Telja kishte luftuar kundër serbëve që në vitet 1918-1925 dhe nuk kishte bashkëpunuar me ta dhe diktatori e pushkatoi për hatër të miqve të tij, Dushan Mugosha, Miladin Popovici e serbë të tjerë, me ne krye agjentin e Ballkanit, Josif Bros Tito.

Tele Baçi, trimi i Mokrës, përveç luftës që kishte bere kundër serbeve dhe me vonë kundër nazifashizmit ishte nacionalist i djathtë që luftonte për një shqiptari demokratike si Shqipëria e sotme. Nuk donte vëllavrasje, donte bashkim kombëtar, pa dallim krahine dhe ideje dhe për këtë arsye bashkëpunonte me



Njoftimi i PKSH për vrasjen e Tele Baçit



Njoftimi i Xhandërmarisë për vrasjen e Tele Baçit

Dulen e Alarupit, Rramanin e Zvarishtit, Haki Blloshin, Niat Çezmën, Hamit Shkozën e të tjerë. Te gjithë ata ishin kundra vëllavrasjes që aplikoi Enver Hoxha, në bashkëpunim me agjunkturën serbe.

Te nderuar lexues, kur është pushkatuar Tele Baçi, në një dokument të

lëshuar nga kuestura italiane e Korçës thuhet: "Komunistët kanë vrarë Tele Baçin dhe kane marre nen vërejtje të vëllanë, Ismailin, dhe dy djemtë, Naimin dhe Sadikun. Nuk dihet gjë për fatin e tyre, ndërsa populli i Mokrës është indinjuar thellë dhe ka ulur kokën në shenjë zie për Tele Baçin".

Ja u citova këto rreshta që të nxirrni konkluzionin se kujt i takon tradhëtia. Atij që ka luftuar për te mbrojtur atdheun, apo atyre që bashkëpunuan me shovinizmin serb për ta bërë atdheun republikën e shtatë të Serbisë?! Kjo ishte e vërteta që diktatori Hoxha e mbuloi me dhe në 4 prill 1944.

“ËNDËRRAT KRYQËZOJNË KOHËN”

Autori: Istref HAXHILLARI
Botoi: Shtëpia botuese “ADA,,
Lloji: Novelë
Shqip e anglisht
Faqe: 136
Çmimi: 400 lekë

Në muajn mars 2010 doli në qarkullim libri “Ëndërrat kryqëzojnë kohën,, novelë e autorit Istref Haxhillari, fitues i çmimit të tretë në konkursin kombëtar për tregimin më të mirë, 23 janar 2010.


Autori Istref Haxhillari vijon pa bujë me librat e tij. Libri “Ëndërrat kryqëzojnë kohën,, risjell një mit të lexueshëm të letrave, me degëzime të shumta në ato shqiptare.

Dashuria burrë-grua është në qëndër të vëmendjes, në fund të fundit, një ëndërr krejt të natyrshëm: jetësimi bashkë, dy zemra-një shpirt, lindjen e fëmijëve, plakjen në paqe. Prandaj ëndërrat kryqëzojnë kohën, në kuptimin çlirohen prej dhe falë saj dhe kryqëzohen nga hapësira, mposhten tragjikisht nga rregullat e bashkësisë.

Rrëfimi është shkruar, pastër me një çiltërsi që del natyrshëm përtej kufijve frymëzues. Mbyllja e rrëfimit përçan një ndjenjë asgjësimi e korrektesie që fshin çdo dallim mes të jetuarit në dashuri dhe të vdekurit në mungesë të saj.

Libri është në një lidhje, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze “Dreams Cross Time,, kjo ndihmon edhe lexuesit e huaj, që e kanë në gjuhën angleze.

Autori Istref Haxhillari, vjen nga shkenca e fizikës, me një karrierë të pasur në rrethin e Pogradecit. Librat e tij pasojnë njëri tjetrit.



-Libri “Përthyerja, në vitin 2007
-Vëllime me ese “BUIS,, në vitin 2008.

-Romanin “Pesha e Kohës,, në vitin 2009

-Vëllimin me proza “ Bari i Ujku,, në vitin 2009

-Libri novella “Endërrat kryqëzojnë kohën,, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, është libri i pestë i tij .

- Tregimi “Thikat e Vardarit,, ka fituar çmim në konkursin kombëtar për vitin 2009, organizuar nga revista “Obelisk, Tiranë.

- Tregimi “Karmencita “ është fitues i çmimit “Don Kishoti”, organizuar nga Ambasada Spanjolle.

Gazeta ‘Mokra,, i uron autorit suksese në botime të tjera sa më të mira .

Zenun FERRO

“NGA DASHURIA PËR NJERËZIT”

Autori: Meri LALAJ
Botoi: Shtëpia botuese ‘Emal,,
Lloji: Publicistikë
Faqe: 190
Çmimi: 500 lekë

Në muajn prill 2010 del nga botimi libri “Nga dashuria për njerëzit,, e autore Meri Lalaj, në publicistikë. Nga viti 1991 e deri tani autorja ka nxjerrë disa libra, dhe niveli i saj është rritur nga një libër tek tjetri.

Autoria Meri Lalaj, nga Bashkia e qytetit të Pogradecit më 6 mars 2010, është nderuar me titullin “Qytetar Nderi,, me motivacionin “Personalitet i shquar në fushën e letrave dhe të përkthimit, e pamposhtur nga vështërsitë e jetës, aktiviste e njohur për të drejtat e gruas,,. Gazeta “Mokra,, me autorin ka patur bashkëpunim të mirë, ajo është autore e disa shkrimeve. Familja e saj ka pasur lidhje me familjen e Milto Lilo në Potkozhan, ka njohur Maro Potkozhanin. Puna e ka lidhur me mokrën, ka qënë në komisionet për përzgjedhjen e kandidatave për këngët, valet në festivale folklorike. Ka qënë nëpër fshatrat e Mokrës, për shpërndarjen e librit nga ana e bibliotekës së qytetit, ka shkruar për këto udhëtime.

Libri i Meri Lalaj “Nga dashuria për njerëzit,, është një publicistikë që fillon nga viti 2001 deri mars 2010. Ajo e fillon me publicistikë “ Dheu kosovar,, “Sheshi i Prizrenit është i shtuar me kalldrëm dhe më kujton Korçën,, (faqe 8).

E kam për nder të them të vërtetën për një njeri të vërtetë, dhe ky ishte Qani Isuf Çollaku. Ai për idetë e tij u luftua



nga sistemi, por ai mbijetoi dhe u nda nga jeta më 24 nëntor 1984.

Nëna e tij Minja, e vajtoi: “ Bir, o bir, më ike si prej plumbit,,. Se Çollakët gjithnjë kanë ikur prej plumbit nga kjo jetë (faqe 14). Qani Çollaku është nderuar me titullin e nderit “Mësues i Popullit,, dhe “Qytetar Nderi i Qarkut të Korçës

Autoria shkruan për jetën e Drita Çomos, për artisten Tinka Kurti, për Andon S.Frashëri i fundmi i dishepujve të Nolit, të gjallët e harrua në Shqipëri, Dr.Maragarita dhe Dr.Fiqiri Basha, shën Valentinin gëzuar ditëlindjen Dritëro, Të uroj shëndet dhe krijimtari të mbarë.

Ditët feste në Kaiserslautern në Gjermani. Duke ndjekur jetën e Xhafize Kekos. Pashë Anglinë me syrin e Londrës. Postier Skënderin nga Pogradeci. Publicistika vazhdon është e shumtë, lexuesi pas leximit individual ka për ta vlerësuar realisht. Autoria Meri Lalaj, thekson se “Shqipëria do të bëhet vetëm me dashuri,, (faqe 185).

Zenun FERRO

SHQIPTARË, KUJDES NGA “MASHTRIMI” I RADHËS!

Për librin e autorit Petrit Mënaj “Dilemat e integritit të Maqedonisë dhe shqiptarët

Nga Zabit CUKU

Libri “Dilemat e integritit të Maqedonisë dhe shqiptarët,, botuar, në Tetovë, viti 2009 me autor Petrit Mënaj, jep analiza, e opinione që i vjen në ndihmë çështjes së kuptimit real të dilemave të integritit të Maqedonisë dhe pozicionimit të politikës shqiptare më me dinjitet duke kërkuar atë që i takon shqiptarëve si autokton e jo si ardhac, siç pretendon kreu i shkencës maqedonase me Enciklopedinë e botuar në vitin 2009, e cila u tërhoq nga qarkullimi. Autori Petrit Mënaj, i njeh çështjet, e problemet e Maqedonisë. Ai ka marrë pjesë aktive atje në ngjarjet e vitit 2001, dhe më vonë. Ka botuar shkrime të shumta për luftën në Kosovë, në Maqedoni dhe publicistikë e shkrime në drejtimin politiko shoqëror e historik. Ka botuar pesë libra nga viti 2001 deri 2009. Libri UÇK mesazh dhe shpresë në tre vëllime është përkthyer edhe në gjuhën maqedonase, ndërsa libri “Dilemat e integritit të Maqedonisë dhe shqiptarët,, është libri i tij i fundit që marrim në duar në lidhje me të ardhmen e Maqedonisë dhe shqiptarëve që banojnë në trojet e tyre Maqedoni. Në vitin 2001, për shqiptarët e Maqedonisë lufta kishte mbetur si alternativë e vetme për t’i mbijetuar persekutimit në rritje të qeverisë maqedonase. Autori Petrit Mënaj ishte një nga drejtuesit e UÇK-së, në çështjet ushtarke , ai tregon kujtimet, dhe vështërsitë se rruga e shqiptarëve në Maqedoni nuk ka qënë e lehtë. Kjo luftë bëri që të arrihet nënshkrimi i marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001. Maqedonasit të udhëhequr nga elita e tyre politike vazhdojnë të njëjtin kurs antishqiptar, por më të kamufluar, e cila duket tek qëndrimi i intelektualëve ndaj shqiptarëve dhe kulturës së tyre, që përveç rasteve të shkëputura për efekte propogandistike, mbetet ai që ka qënë.

Emrat e qyteteve të Ohrit, Manastirit, Strugës dhe Shkupit, si dhe kolonive për rreth, janë të pa ndara me historinë e emrave të qyteteve të vjetra të Shqipërisë së sotme, me Durrësin, Apolininë, Amatiën e tjerë, të cilat flasin për manipulimet e qëllimshme të



politikanëve dhe historianëve sllavë për ti përvetësuar ato.

Dokumentat historike shqiptare janë të pa kontestueshme edhe në trullin ku banojnë sot shqiptarët në Maqedoninë e kontestuar, që prej historisë së ndritur të Filipit edhe Aleksandrit të Madh deri në historinë e re. Është koha kur shqiptarët nuk duhet të heshitin më. Por me të gjitha mjetet, si shoqëria civile, ashtu dhe ajo intelektuale. Kur çdo propozim i shqiptarëve ka ardhur vetëm nëpërmjet luftës dhe vetëvendosjes së popullit, për të fituar. Kjo është një luftë tjetër e cila duhet fituar.

Autori Petrit Mënaj në këtë libër paraljmëron, “Kujdes nga mashtrimi i radhës,, faqe 144.

Parkrahja ndërkombëtare dhe vetëdija kombëtare është më e lartë, ndaj rezultatet për ndryshime në drejtim të përparimit të shqiptarëve në të gjitha fushat duhet të jenë më të shpejta, sepse koha nuk prët. Libri mbyllet nga autori “Prandaj duke qëndruar vigjilent, larg thashethemeve e shpifjeve dashakeqe, duhet të mos mendojmë vetëm sot, por duhet të shikojmë nga e ardhmja...,,

KOLONIA NDËRKOMBËTARE E ARTIT VIZIV “POGRADECI 2010”

Përgjatë një jave nga data 3 deri 7 maj 2010 u mbajt në qytetin e Pogradecit “Kolonja Ndërkombëtare e Artit Viziv Pogradeci “10”. Merrnin pjesë në rreth 20 artistë nga Turqia, Bullgaria, Maqedonia, Kosova, Italia Shqipëria. Mes tyre emra të njohur në vendet nga vinin si Somonida, Pilipova, Denis Tenev, Safet Spahiu, Slavenka Gancheva, Sefka Islegen, Merita Jaha, Jona Dividi, Agron Polovina, etj. Aktiviteti u realizua nga Shoqata “ANTIK,, me mbeshtetjen e MT-KRS si dhe deputetit të zonës, Fatbardh Kandili. Vendi i realizimit të kolonisë ishte Vila “INBLEON”, një ndërtesë karakteristike e ndërtuar në vitin 1922, që u afroi komoditet dhe intimitet artistëve. Gjatë qëndrimit në Pogradec artistët patën mundësi të vizitonin vende turistike

të rajonit si Viskopojë, Lin e tjerë. Me gjithë vizionin modern të artistëve, ata nuk mundën t’i shpëtonin mbresave që u la natyra e Pogradecit. Si pas drejtuesit të projektit Saimir Ahmeti. Kjo koloni është fillimi i një tradite të re, që do të ketë Pogradeci si një pikë takimi për artistët profesionistë, të cilët do të ballafaqojnë vizionet dhe eksperiencat e tyre profesionale, Piktori Anastas Kostandini, e quajti fat që është zgjedhur Pogradeci si vendi i realizimit të projektit. Kjo koloni është pjesa e parë e projektit “POGRADACI 10”, që do të ndiqet nga një tjetër koloni artistike në muajin tetor, me piktore që lëvrojnë gjininë e peizazhit si dhe të Festivalit Mbarëkombëtar të Fjalës Artistike “Pogradeci’10”.